

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XIX, nr. 5824  
E enjte, 11 korrik 2019  
çmimi 0.40 €

## Rexhep Selimi: Kosovës i duhet një qeveri tjetër

FAQE 6



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH  
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", ZENUN PAJAZITI | FAQE 4-5

## Zgjedhjet e reja nuk zgjidhin asnjë problem

- Dialogu është tema  
më serioze me të cilën  
duhet të merremi



Deputeti i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Zenun Pajaziti, ka vlerësuar se shkujarja në zgjedhje të parakohshme nuk do t'i kontribuonte përmirësimit të gjendjes në vend. Përkundrazi, ai ka thënë se

zgjedhjet nuk mund ta zgjidhin asnjë prej problemeve me të cilat po përballlet Kosova. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Pajaziti ka deklaruar se dialogu është tema më serioze me të cilën duhet të merremi dhe, sipas tij, çdo tentim i

shmangies nga kjo temë do ta dobësojë pozicionin e Kosovës. Ai ka theksuar se finalizimi i dialogut me Serbinë është ndër sfidat më të vështira që nga paslufta, por edhe një shans historik për ta përmbyllur këtë kapitull

## Dorëzohet kërkesa për themelimin e komisionit që heton listat e veteranëve

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka dorëzuar të mërkurën kërkesën për themelimin e Komisionit Hetimor Parlamentar i cili do t'i hetojë listat e fryra të veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK-së). Ai ka vlerësuar se UÇK-ja është shumë e madhe për të abuzuar dikush me të. Përveç Kadri Veselit, nënshkrues të kërkesës për komision hetimor janë edhe shtatë deputetë të tjerë të PDK-së që kanë qenë pjesë e luftës së UÇK-së | FAQE 3



## Këtë vit janë arrestuar 984 persona të dyshuar për përdorim të drogës

FAQE 6

### AKTUALE



NAIM MALOKU FTOHET NGA  
GJYKATA SPECIALE NË  
CILËSINË E DËSHMITARIT F. 5

REXHEP SELIMI: SA MË PARË  
DUHET TË SHKOJMË NË  
ZGJEDHJE F. 6

PËRURORHET RINOVIMI I  
KARDIOLOGJISË INVAZIVE F. 7

### EKONOMI

SERBËT NË VERI NUK I  
PAGUAJNË FATURAT E RRYMËS,  
KMDLNJ-JA FTON QYTETARËT  
TË PROTESTOJNË F. 8

MINISTRI SHALA,  
INVESTITORËVE NGA TURQIA:  
KOSOVA KA TATIMET  
MË TË ULËTA NË EVROPË F. 9

### KULTURË

GASHI: MBROJTJA, RUAJTJA  
DHE PROMOVIMI I  
TRASHËGIMISË KULTURORE,  
PRIORITETE TË MKRS-së F. 3

### SPORT

FERONIKELI T'I HAPË DYERT  
E 'FADIL VOKRRIT' F. 16



Sadik ZEQRIRI

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht-Tetovë  
Curëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegijbiznesi.com  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666



## Jep dorëheqje ambasadori britanik në ShBA

LONDËR, 10 KORRIK - Ambasadori britanik në Shtetet e Bashkuara, Kim Darroch, njoftoi të mërkurën për dorëheqje, duke shtuar se e kishte të pamundur ta vazhdonte rolin e tij pas rrjedhjes së informacionit të kabllogrameve diplomatike në të cilat ai kritikonte presidentin amerikan Donald Trump. "Edhe pse mandati im nuk përfundon deri në fund të këtij viti, besoj se në rrethanat aktuale qëndrimi i përgjegjshëm do të

ishte lejimi i emërimit të një ambasadori të ri", tha Darroch në një deklaratë. Kim Darroch ka qenë diplomat kryesor i Britanisë në Uashington që prej vitit 2016. Sipas kabllogrameve të bëra tashmë publike, Darroch e karakterizonte presidentin Trump si një udhëheqës "i ngathët", "i pasigurt" e "i paafte" dhe administratën e tij si "jofunksionale". Pas publikimit të tyre presiden-

ti Trump reagoi me një postim në "Twitter" duke e quajtur Darroch "shumë budalla" dhe një "një njeri të trashë e pompoz". Ai shkruante gjithashtu se nuk do të merrej më me të. Kabllogramet e publikuara u dërgoheshin ministrave të lartë britanikë dhe nëpunësve civilë, por zyrtarët besojnë se personi që ia ka dhënë ato shtypit, është politikan apo zyrtar britanik dhe nuk i takon një qeverie të huaj.



# Von der Leyen kërkon mbështetje për postin e presidentes së KE-së

Për ta marrë shumicën e votave në Parlamentin Evropian, ministrja gjermane e Mbrojtjes, Ursula von der Leyen, po viziton me radhë grupet parlamentare, por ende nuk e ka siguruar zgjedhjen në postin e presidentes së Komisionit Evropian



STRASBURG, 10 KORRIK - 374 është numri magjik, i cili i siguron Ursula von der Leyenit zgjedhjen në postin e presidentes së Komisionit Evropian, sepse Parlamenti Evropian ka aktualisht 747 eurodeputetë. Parlamenti numëron në fakt 751 eurodeputetë, por katër vende ende nuk janë plotësuar. Votimi do të mbahet ditën e martë të javës që vjen, në Strasburg.

Besohet se von der Leyen do të zgjidhet në këtë post, por e sigurt nuk është. Po çfarë politike personifikon ministrja e Mbrojtjes e Gjermanisë, në kabinetin e kancelares Angela Merkel? Këtë ende nuk e di askush saktësisht, ndërkohë që politikania 60-vjeçare nga CDU-ja është ende e panjohur sa duhet për shumë eurodeputetë.

Ursula von der Leyen ka premtuar javën e kaluar se së pari do të dëgjojë se çfarë kanë për të thënë grupet parlamentare dhe ka premtuar se shumë prej këtyre pohimeve do t'i marrë si udhërrëfyes në punën e saj të re në Evropë. "Këtu në Parlamentin

Evropian rreh zemra e demokracisë evropiane", tha von der Leyen, e cila u shpreh e gatshme për dialog. Por shumë ekologjistë nuk u besojnë fjalëve të saj. Ata kërkojnë hapa konkretë, tha zëvendëskryetarja e grupit parlamentar Ska Keller.

Të mërkurën Ursula von der Leyen ka planifikuar të bisedojë me socialdemokratët, liberalët dhe ekologjistët. Por ende nuk dihet, se cilat do të jenë pozicionet e saj në këto takime. Socialistët dhe liberalët duan të bisedojnë me dyer të mbyllura, ndërsa ekologjistët thonë se do të transmetojnë drejtpërdrejt takimin. Por që tani ka sinjale te këto parti se "Evropa nuk duhet të mbetet në duart e von der Leyen". Kryetarja e Grupit parlamentar socialist, spanjollja Iratxe Garcia, nuk është përcaktuar qartë ndaj kandidatës. Por ajo tha se nuk shkon domosdoshmërisht në favorin e von der Leyen fakti që ajo është mbështetur nga grupi i Vishegradit, ku bëjnë pjesë edhe shumë populistë të djathtë. "Por ne nuk do ta paragjykojmë para

se ta dëgjojmë", tha Garcia. Votat e këtyre deputetëve mund të jenë vendimtare për zgjedhjen apo jo të von der Leyen, sepse thuhet se ajo e ka edhe mbështetjen e presidentit të Francës Emmanuel Macron, i cili përfaqëson grupin e liberalëve.

Në Bruksel po bëhen këto llogari. Von der Leyen do të fitojë 182 vota të grupit të Kristiandemokratëve. Për të do të votojnë të paktën edhe 120 eurodeputetë nga grupi i Socialdemokratëve dhe rreth 100 liberalë. Nëse këto llogari janë të vërteta, atëherë von der Leyen i ka të sigurta 402 vota, ndaj nuk varet nga votat e ekologjistëve. Ndërkohë që mendohet se mund të fitojë të paktën edhe 30 vota nga grupi i populistëve të djathtë.

Diplomatët në Bruksel thonë se ajo do t'ia dalë, ndërsa Bundeswehri do të gëzohet. Me këto fjalë preket tema e akuzave serioze kundër ministres së Mbrojtjes, të cilat janë dëgjuar në muajt e fundit në Gjermani, për skandale financiare.

Ursula von der Leyen ka ngritur një zyrë të përkohshme në Komisionin Evropian në godinën Berlaymont, ku së bashku me bashkëpunëtorët po bën fushatën e saj. Kjo lejohet nga Komisioni Evropian. Von der Leyen megjithatë ende nuk ka dhënë dorëheqje nga posti i ministres së Mbrojtjes në Gjermani. Ndaj në rast të dështimit në Strasburg, ajo mund të kthehet në Berlin. Në rast dështimi, presidentët dhe kryem-

ministrat e vendeve anëtare të BE-së duhet të paraqesin një propozim të ri brenda katër javësh. Kaosi politik do të ishte i paevitueshëm, sepse në këtë mënyrë do të kontestoheshin marrëveshjet për Komisionin Evropian, Këshillin e Evropës, presidentin e Parlamentit dhe shefen e Bankës Qendrore Evropiane.

Në rast fitoreje të Ursula von der Leyen, ajo do të ishte femra e parë gjermane që merr këtë post. Dhe do të ishte një kontrast shumë i madh krahasuar me presidentin e deritanishëm Jean-Claude Juncker. Mjekja me një gjatësi prej 1,61 cm, është një grua me disiplinë të hekurt, ha pak ndërsa alkoolin nuk e prek me dorë. (dw).

## Meta takon Pendarovskin

TIRANË, 10 KORRIK - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, ka takuar homologun e vet maqedonas Stevo Pendarovski. "Të dy vendet tona duhet t'i bashkojnë përpjekjet për çeljen e negociatave për anëtarësim në tetor. Duhet të përfitojmë nga ky momentum mjaft pozitiv që ka krijuar Marrëveshja e

Prespës, jo vetëm për Maqedoninë e Veriut. Po kështu ishte kënaqësi ta konstatoja vendosmërinë e presidentit Pendarovski për të bashkëpunuar dhe përfshirë opozitën në dialog për çështjet themelore të shtetit dhe demokracisë", tha Meta. Kreu i shtetit shqiptar nuk ka

lënë pa përmendur edhe krizën në vendin e tij. "Sot bëhet një muaj i shpërdoruar kot që nga dekreti për anulimin e zgjedhjeve të 30 qershorit, për arritjen e një zgjidhje gjithëpërfshirëse që forcon besueshmërinë e vendit për zgjedhje të lira e të ndershme", tha Meta.





Zyrtarizohet iniciativa për themelimin e Komisionit Hetimor Parlamentar për Listat e Veteranëve

# Dorëzohet kërkesa për themelimin e komisionit që heton listat e veteranëve

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka dorëzuar të mërkurën kërkesën për themelimin e Komisionit Hetimor Parlamentar i cili do t'i hetojë listat e veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK-së). Veseli ka vlerësuar se UÇK-ja është shumë e madhe për të abuzuar dikush me të. Përveç Kadri Veselit, nënshkrues të kërkesës për komision hetimor janë edhe shtatë deputetë të tjerë të PDK-së që kanë qenë pjesë e luftës së UÇK-së



**EPOKA  
ERE** **Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 10 KORRIK** - Kryeparlamentari Kadri Veseli ka bërë me dije të mërkurën se ka dorëzuar kërkesën për themelimin e Komisionit Hetimor Parlamentar i cili do t'i hetojë listat e fryra të veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Në profilin e vet në "Facebook", ai ka shkruar se mashtruesit që i kanë fryrë listat e veteranëve janë duke e lënduar emrin e UÇK-së. "Ushtria Çlirimtare e Kosovës është shumë e madhe për të abuzuar dikush me të. Ushtarët e UÇK-së nuk kanë luftuar që të përfitojnë për vete, por që të fitojë Kosova, që qytetarët e saj ta fitojnë lirinë dhe perspektivën. Mashtruesit që kanë fryrë listat e veteranëve janë duke e lënduar emrin e UÇK-së dhe janë duke abuzuar me paratë e qytetarëve tanë. Kjo do të marrë fund", ka shkruar Veseli, duke shtuar se ashtu siç ka premtuar, do të jetë i pakompromis në luftën kundër korrupsionit, nepotizmit dhe abuzimit të pushtetit. "Siç kam premtuar,

ne do ta bëjmë një luftë të pakompromis kundër korrupsionit, nepotizmit dhe abuzimit të pushtetit. Prandaj, unë tashmë kam dorëzuar kërkesën për krijimin e Komisionit Hetimor Parlamentar, i cili do ta hetojë çështjen e listave të fryra të veteranëve dhe që ato të pastrohen. Askush nuk do të jetë mbi ligjin", ka shkruar Veseli.

Në listën e nënshkruesve të kërkesës për komision hetimor, përveç Kadri Veselit janë edhe shtatë deputetë të tjerë të PDK-së që kanë qenë pjesë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës: Fadil Beka, Bekim Haxhiu, Fatmir Xhelili, Hajdar Beqa, Xhavit Haliti, Elmi Reçica, Rafet Rama.

I pari i PDK-së në fillim të kësaj iniciative kishte deklaruar se këto keqpërdorime janë bërë edhe nga ish-komandantë të lartë të UÇK-së. "Zemërimi im, që buron nga përfshirja e mashtruesve në listat e veteranëve, të cilat janë bërë nga disa komandantë abuzues, është arsyeja pse më shtyn të flas dhe të veproj. Duhet ta pranojmë faktin se jo pak njerëz në nivele të larta, edhe

nga ish-UÇK-ja për shumë vjet kanë abuzuar dhe po abuzojnë me fuqinë e tyre. Kjo duhet të marrë fund. Këta njerëz kanë dëmtuar më së shumti reputacionin e UÇK-së, kanë bërë që shumë njerëz të mendojnë se luftëtarët e vërtetë të UÇK-së kanë bërë atë që kanë bërë me qëllim për të përfituar", është shprehur ai.

Asokohe Veseli kishte deklaruar se Komisioni Hetimor Parlamentar me punën e tij duhet të sigurojë që listat e veteranëve të jenë të pastruara nga mashtruesit, në mënyrë që luftëtarët e UÇK-së që kanë nevojë të përkrahen edhe më shumë dhe më denjësisht nga shteti i tyre. "Raporti final i

këtij komisioni do të bëhet publik, i bazuar në ligj, do të jetë në dispozicion të publikut dhe institucioneve të drejtësisë për t'i ndjekur penalisht mashtruesit", ishte shprehur Veseli, duke paralajmëruar se krahas komisionit do t'i iniciojë edhe ndryshimet e duhura në Ligjin për Veteranët e Luftës së UÇK-së.

Iniciativën e Veselit e kanë përkrahur edhe disa ish-komandantë të lartë të UÇK-së. Ish-komandanti i UÇK-së për Zonën Operative të Drenicës, Sami Lushtaku, kishte deklaruar se po e pret me padurim formimin e këtij komisioni, duke u shprehur se ky është gëzimi më i madh i tij

që nga çlirimi i Kosovës. "Pastrimi i listave për mua është gëzimi më i madh që nga çlirimi i Kosovës. Mezi s'po pres që t'i shoh listat e pastruara me vetëm ata veteranë që kanë luftuar përnjëmend. Pastrimi i listave bën që ushtarët që kanë luftuar për këtë vend të ndihen krenarë e jo të rreshtohen me ata që nuk kanë bërë asgjë, të barazohen ata që kanë jetuar në Gjermani me ata që kanë qëndruar në istikame", ka thënë Lushtaku.

Me këtë çështje tashmë është duke u marrë edhe drejtësia. Gjykata tashmë ka konfirmuar aktakuzat për disa ish-komandantë të UÇK-së në lidhje me listat e veteranëve të rrejshëm.

## Gashi: Mbrojtja, ruajtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore, prioritete të MKRS-së

**PRISHTINË, 10 KORRIK (ER)** - Me ftesë të Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka marrë pjesë të mërkurën në dëgjimin publik me temë "Monitorimi i zbatimit të ligjit për trashëgimi kulturore". Ai ka thënë se mbrojtja, ruajtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore është e përcaktuar si një nga prioritetet e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit. "Me gjithë sfidat, e që nuk janë të pakta, sfida këto të trashëguara dhe aktuale, me angazhimet tona, po përipiqemi t'i përm-bushim obligimet, por edhe ta konsolidojmë edhe më tutje gjendjen në terren. Sigurisht se përkujdesja ndaj trashëgimisë kulturore është në mandatin e

ministrisë, por legjislacioni në fuqi obligon edhe shumë institucione të tjera, në nivelin qendror dhe lokal, pronarët, poseduesit dhe shfrytëzuesit e aseteve të trashëgimisë kulturore", ka thënë Gashi.

Ai ka theksuar se janë të vetëdijshëm se korniza ligjore në fushën e trashëgimisë kulturore është mjaft komplekse por, sipas tij, kjo nuk nënkupton që mund t'iu shmangen detyrave dhe obligimeve si MKRS. "Sikurse që jemi të vetëdijshëm se numri i prioritetëve është shumë i madh, kurse kapacitetet institucionale aktuale nuk janë të mjaftueshme. Jemi të përkushtuar të punojmë edhe më shumë që këtë fushë të ndjeshme ta vendosim në binarë", ka thënë ministri Gashi.





Flet për "Epokën e re", Zenun Pajaziti

# Zgjedhjet e reja nuk z

**- Dialogu është tema më serioze me të cilën duhet të merremi**



Deputeti i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Zenun Pajaziti, ka vlerësuar se shkuarja në zgjedhje të parakohshme nuk do t'i kontribuonte përmirësimit të gjendjes në vend. Përkundrazi, ai ka thënë se zgjedhjet nuk mund ta zgjidhin asnjë prej problemeve me të cilat po përballet Kosova. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Pajaziti ka deklaruar se dialogu është tema më serioze me të cilën duhet të merremi dhe, sipas tij, çdo tentim i shmangies nga kjo temë do ta dobësojë pozicionin e Kosovës. Ai ka theksuar se finalizimi i dialogut me Serbinë është ndër sfidat më të vështira që nga paslufta, por edhe një shans historik për ta përmbyllur këtë kapitull

sipas Pajazitit, çdo tentim i shmangies nga kjo temë do ta dobësojë pozicionin tonë. "Para nesh është edhe një sfidë, ndër më të vështirat që nga paslufta, e në anën tjetër edhe një shans historik për ta përmbyllur këtë kapitull aq të errët. Një shans sepse kemi edhe një gatishmëri të partnerëve tanë, sidomos të ShBA-së dhe BE-së, që të kyçen në këtë proces më seriozisht", është shprehur Pajaziti. Ai ka vlerësuar se shkuarja në zgjedhje të parakohshme nuk do t'i kontribuonte përmirësimit të gjendjes në vend. Përkundrazi, Pajaziti ka thënë se zgjedhjet nuk mund ta zgjidhin asnjë prej problemeve me të cilat po përballet Kosova. "Zgjedhjet s'besoj se do ta zgjidhnin asnjë prej këtyre problemeve me të cilat po përballet aktualisht vendi ynë siç janë: dialogu, vizat apo edhe sfidat e tjera që po lidhen

me gjykimin e të kaluarës sonë. Po ashtu, s'besoj se do t'i zgjidhnin as vështirësitë partiake që i kanë ata që po i përmendin përditë zgjedhjet", ka theksuar ai.

**"Epoka e re":** Z. Pajaziti, çfarë është duke ndodhur me iniciativën për themelimin e tribunalit për krimet serbe në Kosovë? Kur do të vijë në Kuvend?

**Pajaziti:** Ishte një nismë e vonuar, por e mirë. Shpresoj të shkojë deri në fund. Sikur edhe temat e tjera, edhe kjo u përdor shumë për agenda partiake, por nuk është se mungonte një disponim i gjerë që kjo duhet të bëhet. Pavarësisht të metave në proces, vonesës së madhe dhe paqartësive, do të ishte mirë ta çonim përpara këtë ide. Edhe pse personalisht nuk mendoj se nisma për një tribunal të tillë do të ndikonte edhe aq shumë

**EPOKA E RE** Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 10 KORRIK - Deputeti i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Zenun Pajaziti, ka bërë thirrje që ideja për themelimin e tribunalit për krime serbe në Kosovë të shkojë deri në fund. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se kjo

ishte një nismë e mirë, edhe pse e vonuar. "Sikurse edhe temat e tjera, edhe kjo u përdor shumë për agenda partiake, por nuk është se mungonte një disponim i gjerë që kjo duhet të bëhet. Pavarësisht të metave në proces, vonesës së madhe dhe paqartësive, do të ishte mirë ta çonim përpara këtë ide. Edhe pse personalisht nuk mendoj se nisma për një tribunal të tillë do të ndikonte edhe aq shumë

në disa rrjedha për të cilat edhe vetë ne kontribuam si për Gjykatën Speciale ashtu edhe për mënyrën si po trajtohet krejt dialogu për një zgjidhje përfundimtare me Serbinë. Mund të themi tashmë se jemi në njëfarë kurthi që, pak a shumë, e kemi ngritur vetë", ka deklaruar Pajaziti. Ai ka thënë se përveç kësaj dialogu është tema më serioze me të cilën duhet të merremi dhe,

# Gjydhin asnjë problem

**"Epoka e re":** Legjislativi deri më tani është karakterizuar me mungesë të kuorunit, me ç'rast ka dështuar mbajtja e shumë seancave dhe miratimi i ligjeve dhe rezolutave. Duke pasur parasysh këtë fakt, edhe sa mund të funksionojë kështu koalicioni qeverisës në Kuvend?

**Pajaziti:** Mungesa e kuorunit ishte më shumë edhe si mjet i opozitës për ta nxjerrë koalicionin qeverisës si jofunksional. Pra, numrat përdorëshin më shumë kur kishte ndonjë mungesë të deputetëve të mazhorancës si mjet për ta krahasuar fuqinë. Por, në anën tjetër, nuk kishte numra të mjaftueshëm për ndonjë agjendë tjetër të opozitës. Ka pasur situata të tilla edhe më përpara në legjislaturat e mëhershme. Kjo nuk do të përbënte ndonjë problem për funksionim të Kuvendit, aq më tepër të ekzekutivit. Por, nëse çështjet e tjera që janë vitale, siç është puna e buxhetit apo e temave me interes për vendin si ajo e integritetit apo çështjet që lidhen edhe me nisma dhe përkrahje të partnerëve tanë strategjikë nuk ecin përpara, kjo do ta bllokonte ecjen përpara të kësaj legjislature.

**"Epoka e re":** Në fakt, opozita ka paralajmëruar ngritjen e mocionit të mosbesimit ndaj qeverisë. Ndihet e rrezikuar pozita nga një mocion i tillë?

**Pajaziti:** Për shëndetin e demokracisë dhe për të mirën e vendit gjithmonë pushteti do të duhej të ndihej i 'rrezikuar' nga nismat e opozitës për votëbesim apo rrëzim. Në rastin tonë nuk është as njëra e as tjetra. Edhe qeveria here pas here po sillet tepër komode, nganjëherë edhe me fodullëk. Në anën tjetër, opozita krejt joserioze dhe me dallime të mëdha deklarohet dhe sillet në jetën politike. Kurdo që numrat në Kuvend ndryshojnë do të ndryshojë edhe skena politike dhe rrjedhat në vend.

**"Epoka e re":** A do të ketë apo jo zgjedhje këtë vit?

**Pajaziti:** Nuk mund ta di. Kjo pyetje më shumë mund të ishte për ata që kanë ide të tilla dhe nisma të tilla. Zgjedhjet nuk besoj se do të zgjidhnin asnjërin prej këtyre problemeve me të cilat po përballet aktualisht vendi ynë siç janë: dialogu, vizat apo edhe sfidat e tjera që po lidhen me gjykimin e të kaluarës sonë. Po ashtu, s'besoj se do t'i zgjidhnin as

vështirësitë partiake që i kanë ata që po i përmendin përditë zgjedhjet.

**"Epoka e re":** Me apo pa zgjedhje, si e shihni ecurinë e dialogut me Serbinë dhe agjendën evropiane?

**Pajaziti:** Kjo mendohet është tema më serioze me të cilën duhet të merremi. Çdo tentim i shmangies nga kjo temë qoftë me zgjedhje qoftë duke u marrë me tema të tjera veçse do ta dobësojë pozicionin tonë. Para nesh është edhe një sfidë, ndër më të vështirat që nga paslufta, në anën tjetër edhe një shans historik për ta përmbyllur këtë kapitull aq të errët. Një shans sepse kemi edhe një gatishmëri të partnerëve tanë, sidomos të

ShBA-së dhe të BE-së që të kyçen në këtë proces më seriozisht. Në fazat e mëhershme kishim një përvojë më të mirë për sa i përket dialogut. Pavarësisht prej kundërshtive, kemi pasur një lloj konsensusi. Kjo që pamë në dy vjetët e fundit, e sidomos këtë vit, duke zhvendosur këtë temë në një debat të brendshëm, në mënyrën më të padobishme për ne, ndërkohë që ende s'kishim një platformë dhe as një ide se si, kur dhe çka do të shtrohej në tryezën e bisedimeve. Kjo ishte dhe është një sinjal i keq për ne. Pra, ka një mungesë të theksuar të koordinimit dhe një shfrytëzim të kësaj teme për agjendat të vogla politike, duke e dëmtuar

interesin e Kosovës. Akuzat e ndërsjella e kanë humbur edhe besimin në lidhshmëri, por edhe seriozitetin që të fokusohemi në gjithçka që është me interes për vendin, për gjithë shqiptarët që vuajtën dhe po vuajnë ende nën regjimin serb e, po ashtu, edhe për të gjithë qytetarët pa dallim. Shpresoj në një këndellje të të gjithë atyre që kanë përgjegjësi dhe atyre që po kërkojnë më shumë përgjegjësi. Kemi qenë të bekuar nga Zoti për krejt si kemi ardhur deri këtu. Besoj shumë që nuk do të bëjmë ndonjë gabim që do ta rrezikonte këtë bekim dhe këtë fitore të jashtëzakonshme.

## Naim Maloku ftohet nga Gjykata Speciale në cilësinë e dëshmitarit

PRISHTINË, 10 KORRIK (ER) - Ish-komandanti i UÇK-së, Naim Maloku, është ftuar nga Gjykata Speciale. Ai është ftuar për intervistim në cilësinë e dëshmitarit. Lajmin e ka bërë me dije vetë Naim Maloku nëpërmjet një postimi në llogarinë e vet në "Facebook". Maloku, pasi ka marrë ftesën përmes telefonit nga Gjykata Speciale, ka bërë me dije se nuk do të mund të udhëtojë për në Hagë për

shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore, pasi para disa ditësh i është nënshtruar në Slloveni një operacioni kirurgjik. "Bashkëluftëtarë të mi, familjarë dhe miq! Ju njoftoj që sot, përmes telefonit dhe në gjuhën sllovene, jam kontaktuar nga Gjykata e Hagës me ftesë që të paraqitem në ditët në vijim për intervistim në cilësinë e dëshmitarit. Ju njoftoj, gjithashtu, që është hera e

parë që unë kontaktohem nga kjo gjykatë. E njoftova gjykatën që për shkak të gjendjes së rënduar shëndetësore unë nuk mund të udhëtoj për atje. Angazhimi im në përpjekjet e popullit tim për liri, i kurorëzuar me të qenit oficer i lartë në të shenjtën UÇK, më bën të ndihem krenar tërë jetën duke lënë trashëgiminë më të çmuar për pasardhësit e mi", ka thënë Maloku.



në disa rrjedha për të cilat edhe vetë ne kontribuam si për Gjykatën Speciale ashtu edhe për mënyrën si po trajtohet krejt dialogu për një zgjidhje përfundimtare me Serbinë mund të themi tashmë se jemi në njëfarë kurthi që, pak a shumë, e kemi ngritur vetë.

**"Epoka e re":** Së shpejti Kuvendi pritët të shkojë në pushim. Si e vlerësoni këtë periudhë të funksionimit të këtij institucioni dhe a prisni në shtator dinamikë të re?

**Pajaziti:** Kishte vështirësi, por edhe punë, ani pse me shumë zhurmë. Kishte vështirësi në aprovimin e disa ligjeve dhe rezolutave, por kishte, si kurrë më parë, debate të ngritura dhe pyetje për qeveritarët. Nëse agjenda e mbetur nuk arrihet të realizohet tash, me siguri në vjeshtë do të ketë shumë më shumë punë.



Konstituohet Task-Forca antidrogë dhe siguri në shkolla

## Këtë vit janë arrestuar 984 persona të dyshuar për përdorim të drogës

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj, ka treguar se vetëm në këtë vit janë arrestuar 984 persona të dyshuar për përdorim të drogës, në mesin e tyre 194 nxënës. Ndërkaq shefi i Task-Forcës Shtetërore për Antidrogë dhe Siguri në Shkolla, Avdullah Hasani, ka thënë se qëllimi i formimit të kësaj Task-Force është mbrojtja e të rinjve nga përdorimi i drogave



u bazuar në nevojën dhe kërkesën e kryeministrit që institucionet të ofrojnë siguri për të rinjtë. Qëllimi i formimit të Task-Forcës është mbrojtja e të rinjve nga përdorimi i drogave", ka thënë Hasani.

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj, ka treguar se vetëm në këtë vit janë arrestuar 984 persona të dyshuar për përdorim të drogës, në mesin e tyre 194 nxënës. "Aktiviteti ka qenë shumë i madh në fushën e parandalimit të drogave në shkolla dhe jashtë shkollave. Për parandalimin e këtyre dukurive jemi marrë me shumë aktivitete dhe kemi bërë shpërndarjen e fletushkave. Janë arrestuar 984 persona, 194 nxënës, 790 nuk kanë qenë nxënës. Janë bërë 31 mijë e 125 vizita kontakte në shkolla, janë kontrolluar 68 mijë persona dhe janë kontrolluar 36 mijë e 659

vetura. Janë mbajtur 565 ligjëratë në shkolla dhe mbi 33 mijë fletushka u janë shpërndarë nxënësve", ka thënë Qalaj.

Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, ka thënë se janë të angazhuar që me bashkëpunim të krijojnë një vend më të sigurt për fëmijët. "E mira e kësaj Task-Force është se po bëjmë një bashkëpunim të përbashkët ku fëmijët tanë do të kenë një vend të sigurt. MMPS-ja ka bashkëpunim edhe me

Policinë e Kosovës", ka thënë ai.

Zëvendëskryeprokuroja Sevdije Morin ka thënë se gjatë vitit 2019 prokuroritë kanë trajtuar 511 raste të dyshuarave për përdorim të drogës. "Gjatë vitit 2019 prokuroritë kanë pranuar 511 raste. Prokurori i Shtetit ka për detyrë hetimin dhe ndjekjen e veprave penale. Ne merremi edhe me parandalimin e veprave penale, prokuroria përpiket në forma të ndryshme për dukuritë të cilat shkatërrojnë shoqërinë tonë. Sa i përket luftës kundër narkotikëve, prokuroritë kanë bërë një punë të madhe dhe shpresoj që nga ky takim të dalim me një qëndrim të përbashkët dhe të flasim për gjëra pozitive", ka thënë Morina.

Ndërsa ministri i Punëve të Brendshme, Ekrem Mustafa dhe ministrja e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Dijana Zhiviq, premtuan angazhim dhe përkrahje për Task-Forcën antidrogë tek të rinjtë.

EPOKA  
ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 10 KORRIK - Të mërkurën është mbajtur takimi konstituiv i Task-Forcës kundër drogës dhe sigurisë në shkolla. Në këtë takim ishin të pranishëm ministra, zëvendësministra, drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, zëvendëskryeprokuroja e Shtetit, Avokati i Popullit, të cilët e informuan Task-Forcën lidhur me aktivitetet e deritanishme dhe masat që propozojnë të zhvillohen në kuadër të Task-Forcës dhe fushatës kundër narkotikëve të të rinjtë.

Shefi i Task-Forcës Shtetërore për Antidrogë dhe Siguri në Shkolla, Avdullah Hasani, ka thënë se qëllimi i formimit të kësaj Task-Force është mbrojtja e të rinjve nga përdorimi i drogave. "Task-Forca u krijua duke

## Rexhep Selimi: Kosovës i duhet një qeveri tjetër

Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Rexhep Selimi, u ka bërë thirrje të mërkurën forcave politike që sa më parë ta çojnë vendin në zgjedhje të reja prej nga do të krijoheshin kushtet që presidenti Hashim Thaçi të largohej nga ky post. "Kosovës i duhet një Kuvend tjetër dhe një tjetër qeveri që do ta merrte përsipër mbrojtjen e vendit nga planet serbo-ruse të Thaçit", ka thënë Selimi



PRISHTINË, 10 KORRIK (ER) - Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Rexhep Selimi, në një konferencë për medie të mërkurën ka folur në lidhje me incizimet e publikuara ku dëgjohej kryeministri i Maqedonisë së Veriut, Zoran Zaev, teksa flet për planet e fshehta për ndarje të Kosovës. "Në këto biseda të bëra në vjeshtën e vitit 2018 dhe në fillim të vitit 2019, Zaevi shpreh shqetësimin e drejtpërdrejtë se presidenti i Kosovës përmes planit për copëtim të Kosovës e ndryshim të kufijve, po vepron sipas skenarit të Moskës", ka thënë Selimi.

Ai ka thënë se pavarësisht se ka me dhjetëra vendime e veprime të Thaçit në dëm të Kosovës, ajo

që është dëgjuar nga kryeministri Zaev është tejet shqetësuese. "Thaçi duke mashtruar popullin e Kosovës, duke bërë marrëveshje të fshehta, duke i ndërruar fjalët, po vazhdon ta shtyjë përpara planin e Moskës për Kosovën. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese fatmirësisht e ndal shprehimisht Thaçin prej vazhdimit të një dialogu të tillë, por duket se kjo nuk do të mjaftojë. Këtë njeri duhet ta ndalim që të shpëtojë Kosova. Një njeri i shantazhuar me dosje të reja e të vjetra nga Serbia nuk mund ta përfaqësojë Kosovën në raport me Serbinë", është shprehur Selimi.

Më tutje, Selimi ka thënë se,

pavarësisht prej deklaratave të Zaevit, nuk presin që presidenti Thaçi të japë dorëheqje. "Ai nuk jep dorëheqje as kur kapet në skandale, as kur kapet në shkelje të Kushtetutës e as kur kapet në tradhti ndaj interesave kombëtare. Njerëz të tillë që kanë në plan këso pazare nuk japin dorëheqje asnjëherë. Tash kur

botërisht ai po njihet si njeri i Rosisë, Kosova nuk e ka luksin të mbajë në krye një njeri të tillë. Zgjedhjet e menjëhershme janë porta drejt zgjidhjes. Ne iu bëjmë thirrje forcave politike që sa më parë ta çojmë vendin në zgjedhje prej nga do të krijoheshin kushtet që ky president të largohej. Sa më parë që të shkojmë në zgjedhje

aq më mirë për Kosovën ndaj së cilës tashmë ka plane të këqija e të fshehta. Kosovës i duhet një Kuvend tjetër dhe një tjetër qeveri që do ta merrte përsipër mbrojtjen e vendit nga planet serbo-ruse të Thaçit dhe që do ta hetonte veprimtarinë e tij antishtetërore", është shprehur Selimi.



# Hoxha: Franca, Holanda dhe Belgjika kanë dilema për liberalizimin e vizave

Ministrja e Integrimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka thënë të mërkurën, para Komisionit Parlamentar për Politikë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike, se Franca, Holanda dhe Belgjika kanë dilema për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës.

**EPOKA ERE** Qendresa RAMA

PRISHTINË, 10 KORRIK - Ministrja e Integrimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka raportuar të mërkurën për procesin e liberalizimit të vizave para Komisionit Parlamentar për Politikë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike. Ministrja Hoxha ka përshkruar kronologjinë e këtij procesi, nga korriku i vitit 2018, kur Komisioni Evropian (KE) dha rekomandim pozitiv për liberalizimin e vizave, pastaj nga gushti i viti 2018 Komiteti i Parlamentit Evropian (PE) për Liri Civile, Drejtësi dhe Çështje të Brendshme votoi në favor të rekomandimit të KE-së për liberalizimin e vizave për qytetarët tanë. "Edhe pse çështja e liberalizimit të vizave është çështje e ndarë prej raportit të vendit, në raport të këtij viti KE-ja vuri në

pah se Parlamenti Evropian mbështeti propozimin e Komisionit për liberalizimin e vizave dhe që propozimi tani është në pritje në Këshill dhe, si i tillë, duhet të trajtohet si çështje urgjente", ka potencuar ministrja Hoxha.

Hoxha ka folur edhe për shkaqet e zvarritjes së këtij procesi, si konteksti politik brenda BE-së, sidomos periudha rreth zgjedhjeve të Parlamentit Evropian, të mbajtura nga 23-26 maj 2019. "Parlamenti Evropian edhe një herë më 2019 e ka votuar raportin. Pavarësisht prej rekomandimeve pozitive dhe përbushjes së kriterëve, jemi duke pritur vendimin e Këshillit. Në zvarritje ka ndikuar edhe gjendja politike brenda Parlamentit Evropian. Në takimin që kemi pasur në Gjermani me ministrin e Brendshëm, kemi marrë mbështetje për vizat. Por, Franca, Holanda, Belgjika kanë



dilema për liberalizimin e vizave në Kosovë", ka theksuar Hoxha para deputetëve të Komisionit parlamentar. Ajo ka thënë se Kosova tashmë duhet ta presë vendimin e Këshillit të BE-së, por kjo nuk do të thotë se duhet të qëndrojnë duarkryq. Sipas Hoxhës, Kosova i ka përbushur të gjitha kriteret e Bashkimit Evropian por, për shkak të këtyre hezitimeve, nuk dihet se kur do të hidhet në votim në Këshillin e Ministrave çështja e heqjes së vizave për

qytetarët e Kosovës. "Ministria që unë drejtoj do të vazhdojë t'i koordinojë proceset kyçe për implementimin e reformave të nevojshme dhe veprimet e tjera që i takojnë këtij procesi. Ndër kriteret kyçe për liberalizim të vizave është lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, pra është e rëndësishme që t'i fuqizojmë përpjekjet tona në këtë drejtim", ka thënë ministrja Hoxha, duke shtuar se është e rëndësishme që Kosova në fushën e sundimit të ligjit të

shënojë përparim. Hoxha ka shtuar se Këshilli i BE-së tani është nën udhëheqjen e Finlandës. "Vend përkrahës i synimeve tona për integrim në BE. Shpresoj se do të kemi hapa pozitivë në këtë drejtim", ka deklaruar Hoxha.

Anëtarët e komisionit parashtruan pyetje të ndryshme rreth procesit integruar dhe liberalizimit të vizave për ministrin Hoxha, duke vlerësuar se do ta ofrojnë përkrahjen për këtë proces.

## Përurohet rinovimi i Kardiologjisë Invazive



Drejtori i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK), Basri Sejdiu, i shoqëruar nga kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli dhe ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, kanë bërë përrurimin e repartit të Kardiologjisë Invazive, ku ka nisur puna me sallën e dytë të koronarografisë dhe është rinovuar i gjithë reparti, duke krijuar edhe receptionin i cili krijon lehtësira për pacientët

**EPOKA ERE** Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 10 KORRIK - Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, i shoqëruar nga kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, kanë përruruar të mërkurën rinovimin e Kardiologjisë Invazive. Gjatë kësaj vizite ministri Ismaili ka thënë se pas një pune të madhe

dvyjeçare tani është transformuar tërësisht një nga shërbimet më të rëndësishme shëndetësore në QKUK. "Është një ditë shumë e mirë për të gjithë qytetarët e Kosovës sepse tani në dy salla funksionale në Kardiologjinë Invazive, kushdo që do të ketë probleme me zemër në Kosovë, mund të vijë dhe të trajtohet shpejt, pa dallim dhe pa asnjë intervenim", ka

thënë ministri Ismaili. Ai ka treguar se është punuar shumë gjatë kësaj kohe që këtë shërbim që ka dëmtuar shëndetin dhe xhepin e qytetarëve ta rregullojnë dhe ta modernizojnë. Kardiologjia Invazive, e pajisur me aparaturë moderne dhe e rinovuar tërësisht, tani është e gatshme për t'iu përgjigjur të gjitha shqetësimeve që qytetarët tanë kanë me zemër

Ndërsa kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka përshëndetur reformat që po realizohen në sektorin e shëndetësisë. Veseli ka thënë se ky është një transformim i jashtëzakonshëm i cili po i jep fund maltremit dhe varfërimit të qytetarëve të Kosovës në kërkim të një shërbimi shëndetësor. "Punë e jashtëzakonshme, sukses i jashtëzakonshëm. Kjo tregon që kur të bëhen bashkë profesionalizmi dhe vullneti politik, gjëra të rëndësishme për qytetarët ndodhin", është shprehur Veseli. Drejtori i ShSKUK-së, Basri Sejdiu, ka përmendur edhe nisjen e programit për trajtimin e

infarktut në dy orët e para pas sulmit. Pas nisjes së shërbimit 24 orësh në Kardiologji Invazive është hequr lista e pritjes për stentim e cila vetëm gjatë vitit 2018 u ka shpëtuar qytetarëve rreth 12 milionë euro. Përveç pajisjes me aparaturë moderne, në këtë klinikë është bërë përfundimisht edhe ndarja në mes të punëve administrative dhe atyre mjekësore.

Tashmë të gjitha procedurat administrative menaxhohen nga receptioni, duke filluar nga marrja e informacioneve, tërheqja e dokumenteve dhe caktimi i terminëve për koronarografi dhe stentim.



## Austria ofron përkrahje për zhvillimin e bujqësisë

PRISHTINË, 10 KORRIK (ER) - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), Dijana Zhiviq, ka pritur të mërkurën në takim ambasadorin e Austrisë në Prishtinë, Gernot Pfandler dhe drejtorin e Agjencisë Austriake për Zhvillim (ADA), Gunther Zimmer.

Ministria Ziviq ka falënderuar ambasadorin Pfandler për vizitën dhe e ka njoftuar me pro-

gramet mbështetëse të MBPZHR-së si dhe për projektet që ministria do t'i zbatojë këtë vit.

Në takim është biseduar rreth mundësisë së realizimit të projekteve konkrete në fushën e bujqësisë, siç janë prodhimi organik, përkrahja e fermerëve të rinj, hapja e vendeve të reja të punës dhe mbështetja për zhvillimin e zonave rurale.

Ambasadori Pfandler ka thek-

suar rëndësinë e sektorit të bujqësisë për zhvillimin ekonomik dhe me këtë rast ka ofruar përkrahje përmes ekspertizës për avancimin e sektorit të bujqësisë në Kosovë. Ministria Ziviq dhe ambasadori Pfandler shprehën interesin e tyre të përbashkët për ta inkurajuar zhvillimin e bujqësisë me qëllim të përmirësimit të standardit jetësor në Kosovë.



## Serbët në veri nuk paguajnë faturat e rrymës, KMDLNj-ja fton qytetarët të protestojnë

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 10 KORRIK - Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNJ) përmes një reagimi për media ka theksuar të mërkurën se që nga përfundimi i luftës, përkatësisht që nga viti 1999 e deri në vitin 2018, qytetarët e Kosovës (joserbë) kanë qenë të detyruar të paguajnë për rrymën e shpenzuar nga serbët e veriut dhe, mbase, edhe për shpenzimet e tjera siç janë faturat për ujë, ngrohje, mbeturina etj., ndërkaq që tatimin për pronë nuk e kanë paguar kurrë. "Operatorët për prodhim dhe distribuim të rrymës në Kosovë, më herët KEK-u dhe tash KEDS-i, në mënyrën më kriminale të mundshme tinëzisht kanë

plaçkitur paguesit e rregullt të rrymës së shpenzuar, e që më shumë se 93 për qind kanë qenë shqiptarë, në mesin e të cilëve një përqindje e madhe kanë qenë raste sociale, duke ua ngarkuar faturat edhe me shpenzimet që i kanë bërë serbët e katër komunave në veri të Kosovës", është thënë në reagimin e KMDLNj-së.

KMDLNj-ja ka theksuar se edhe pas vendimit të Gjykatës së Apelit, serbët e veriut edhe më tutje refuzojnë t'i paguajnë faturat për rrymë dhe shërbimet e tjera. "Pas reagimeve të shumta të qytetarëve të plaçkitur, të KMDLNj-së dhe të Avokatit të Popullit, Gjykata e Apelit mori vendim që të ndërpritet ky lloj abuzimi dhe hajnie institucionale, ndërkaq Qeveria e Kosovës premtoi se do të kom-

pensohen qytetarët e dëmtuar për më shumë se 17 vjet e që deri më tani nuk janë kompensuar. Serbët e veriut të Kosovës edhe më tutje refuzojnë t'i paguajnë faturat për rrymë dhe shërbime të tjera, ndonëse buxheti i Kosovës dëmtohet për më shumë se 12 milionë euro në vit. Shteti i Kosovës nuk vepron në veri, ndërkohë që edhe për borxhin më të vogël të faturës për rrymë të shpenzuar, KEDS-i përmes përmbauesve ua bllokoi llogaritë bankare edhe kategorive sociale", thuhet në këtë reagim.

Sipas KMDLNj-së, KEDS-i, përveçse i shkyçë nga rrjeti i furnizimit ata që nuk e paguajnë rrymën në afatin e paraparë, po për rikujtje e inkason edhe një taksë shtesë në formë të gjobitjes. "Një pjesë e kriminalizuar e

ndërkombëtarëve, në partneritet me një pjesë të kriminalizuar të politikës kosovare, ka kontribuar në forcimin dhe mirëmbajtjen e strukturave kriminale serbe në veri, ndërkaq që roli i Serbisë në aktivitete kriminale nuk është penguar me asgjë, madje është inkurajuar nga ndërkombëtarët në emër të normalizimit të raporteve me Serbinë. Ligjet e Kosovës si dhe Kushtetuta e saj garantojnë barazi dhe trajtim jodiskriminues për të gjithë qytetarët e saj e që në rastin konkret diskriminimi është aq flagrant e që nuk ndodhë në asnjë vend të botës. Për shpenzimet e bëra duhet të vlejnjë standardet e njëjta, atë që shpenzoni, duhet edhe të paguani pa bërë dallime në baza etnike, fetare, gjinore, moshore, racore, bindjeve politike etj. Pse

shqiptarët dhe joserbët duhet të paguajnë, ndërsa serbët nuk paguajnë kurrë dhe asgjë, ndërkohë që ndaj tyre nuk vlen orari i reduktimeve!?", është thënë në këtë reagim.

KMDLNj-ja ka bërë thirrje që qytetarët e Kosovës në mënyrë të organizuar duhet ta kundërshtojnë këtë diskriminim dhe vendosje të standardeve të dyfishta duke protestuar dhe duke kërkuar trajtim të barabartë. "Institucionet e Kosovës duhet të dëshmojnë se janë shtet dhe se nuk pranojnë që serbët të sillen në këtë mënyrë. Ndryshe, eskalimi i situatës në Kosovë, fillimisht i natyrës sociale, duhet dhe do të jetë i pashmangshëm e që pastaj do të përcillet me destabilizim politik edhe të situatës së sigurisë", thuhet në reagimin e KMDLNj-së.



## Neglizhenca e investitorit privat dhe inspeksioni i Komunës së Prishtinës lënë pa ujë të pijshëm tri zona

PRISHTINË, 10 KORRIK (ER) - Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Prishtina" ka njoftuar të mërkurën konsumatorët e saj se, duke filluar nga Pallati i Drejtësisë, fshati "Amerikan" dhe lagja Veternik, janë me mungesë të furnizimit me ujë të pijshëm. "Më 4 korrik është dëmtuar tubi PE 250 mm me një gjatësi 140 metra nga investitorë privatë të cilët janë duke ndërtuar objekte kolektive në afërsi të Pallatit të Drejtësisë.

Inspeksioni komunal atë ditë ishte në vendngjarje dhe ka obliguar investitorin që të marrë masa sa më shpejt për sanimin e gjendjes së krijuar. Për një kohë të gjatë nuk u morën masa konkrete, edhe pse natyra e dëmtimit të tubacionit të ujit ishte e vështirë për sanim në kohë të shkurtër. Me këtë rast, duke mos parë asnjë interesim nga ana e palëve të tjera, KRU 'Prishtina' mori përsipër dëmin e shkaktuar nga dikush tjetër

dhe e sanoi atë për hir që konsumatorët e zonave të lartcekura të mos mbesin pa ujë. Sanimi zgjati gjithë ditën, deri në mesnatë. Po atë ditë i është rekomanduar investitorit që të merren masa konkrete mbrojtëse që të parandalohet ndonjë defekt më i madh, me ç'rast sërish mund ta pësonin konsumatorët e atyre lagjeve", thuhet në njoftimin e KRU "Prishtina". Sipas kësaj kompanie, të martën, pas neglizhencës së



investitorit dhe inspeksionit të Kuvendit Komunal të Prishtinës, ka ardhur deri te kolapsi i terrenit dhe është shkaktuar dëm edhe

më i madh ku, përveç zonave të lartcekura, të mërkurën pa ujë të pijshëm ka mbetur edhe Pallati i Drejtësisë në tërësi.



# Ministri Shala investitorëve nga Turqia: Kosova ka tatimet më të ulëta në Evropë



**EPOKA  
ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 10 KORRIK - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, ka pritur të mërkurën në takim një delegacion të sipërmarrësve nga Turqia për të diskutuar për mundësitë e investimeve në Kosovë. Shala para sipërmarrësve tregoi për mundësitë që ofron Republika e Kosovës për investitorët e huaj, nga taksat e deri te Ligji për Investime Strategjike. "Kosova ofron mbrojtje për investitorët e huaj, ku i garantohet i gjithë investimi i tyre përmes Ligjit mbi

investimet e huaja, njëkohësisht edhe Ligjit për Investime Strategjike. Për më tepër, përveç sistemit efikas të taksave, Kosova ofron tatimet më të ulëta në Evropë, duke ua ofruar investitorëve të huaj vetëm 10 për qind në profit të korporatave dhe vetëm 5 për qind kontribut të detyruar të pensioneve dhe një nder përfitimet kryesore që investitorët kanë në Kosovë është taksa në dividendë e cila është zero për qind", ka thënë ministri Shala.

Për t'i krijuar kushtet të favorshme për investitorët e huaj, ministri sqaroi se janë krijuar nëntë zona

ekonomike. "Me qëllim që t'i stimulojmë dhe inkurajojmë investimet e huaja në Kosovë, ne kemi krijuar në total nëntë zona ekonomike si një potencial shtesë për investitorë nga Turqia dhe vende të ndryshme për të investuar në vendin tonë", ka thënë Shala.

Ministri Shala ka theksuar se që nga viti 2007 deri më sot në Kosovë janë investuar nga kompanitë turke 331 milionë euro. Shala ka shtuar se Kosova dhe Turqia kanë ratifikuar marrëveshjen për tregti të lirë, që do t'i lehtësojë marrëdhëniet tregtare. "Në raport me investi-

torët nga Turqia, Kosova ka lehtësuar edhe më tutje procesin e investimeve të tyre duke nënshkruar marrëveshje që shërbejnë për investitorët nga Turqia. Dua të përmend para jush që Kosova dhe Turqia kanë ratifikuar marrëveshjen e tregtisë së lirë, e cila lehtëson në masë të madhe investimet e dyanshme dhe nxitjen e tregtisë në mes të dy vendeve. Po ashtu, me Republikën e Turqisë, Republika e Kosovës ka të nënshkruar marrëveshjen për mbrojtje dhe promovimin e investimeve si një mekanizëm shtesë për nxitje dhe mbrojtje të investimeve", ka deklaruar Shala.

Ndërsa Nail Olpak, kryetar i organizatës ekonomike DEIK-DTIK, ka treguar për punën që bën organizata që ai udhëheq dhe ka bërë me dije se përmes kësaj platforme që ofrojnë mund të hapen rrugë për Kosovën. "Me kërkesën e kryeministrit tonë, në kuadër të kontakteve me komitetet që vijnë dhe dalin në Turqi, nëse kanë ndonjë lidhje me ndonjë biznesmen, i gjithë organizimi bëhet nga ana jonë. Kjo është lidhja jonë si organizatë me qeverinë. Kemi 146 këshilla në gjithë botën. Kjo është platformë e rëndësishme që mund t'i hap rrugë Kosovës", ka thënë Olpak.

## OEK-u: Gjykata komerciale rrit sigurinë juridike për bizneset vendore dhe investimet e huaja

PRISHTINË, 10 KORRIK (ER) - Oda Ekonomike e Kosovës (OEK) ka mirëpritur iniciativën e Ministrisë së Drejtësisë, e përkrahur nga USAID-i, për përgatitjen e bazës ligjore që mundëson krijimin e Gjykatës Komerciale. "Gjykata Komerciale mund të jetë një nga shtyllat kryesore të garantimit të sigurtisë juridike për bizneset vendore dhe investitorët e huaj. Besojmë se krijimi i kësaj gjykate do ta adresojë brengën serioze të bizneseve vendore dhe të investitorëve të huaj që vjen sot nga

mungesa e sigurtisë juridike për shkak të mosfunksionimit efikas të sistemit gjyqësor", ka vlerësuar OEK-u.

Sipas OEK-ut, të gjitha rekomandimet e komunitetit të biznesit në vend dhe të investitorëve potencialë e favorizojnë krijimin e Gjykatës Komerciale e cila mund të garantojë mjete efektive juridike për trajtimin e të gjitha lëndëve nga fusha e drejtësisë komerciale. "Krijimi i kësaj gjykate, sipas pritjeve tona, do t'i shërbejë komunitetit të biznesit vendor dhe investitorëve të huaj



si një adresë e vetme, efikase dhe e specializuar për t'i zgjidhur mosmarrëveshjet e tyre nga aktivitetet e tyre biznesore. Kështu, komuniteti i biznesit në Kosovë pret që Gjykata

Komerciale do të jetë një 'One-Stop Shop' për trajtimin e të gjitha rasteve komerciale nga profesionistët që do të trajtohen dhe zhvillohen profesionalisht, konform praktikave më të mira ndërkombëtare të drejtësisë komerciale", thuhet në komunikatën e OEK-ut.

Në këtë drejtim, OEK-u pret që kjo gjykatë të ketë juridiksion të qartë dhe t'i evitojë rastet e duplikimit të kompetencave dhe nevojat e fragmetimit të rasteve në disa dhoma e në disa gjykata për të njëjtën çështje. "Presim që,

krahas krijimit dhe fuqizimit të kësaj gjykate, të investohet dhe ngritet vëmendja e publikut edhe për përdorimin e mjeteve të tjera alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, të cilat edhe më tepër do ta promovonin formalizimin e ekonomisë dhe zgjidhjen e të gjitha sfidave biznesore përmes rrugëve të mjeteve juridike në dispozicion. OEK-u do ta avokojë fuqishëm krijimin e kësaj gjykate dhe do ta ofrojë ekspertizën e vet në të gjitha fazat e procesit të krijimit të kësaj gjykate", është thënë në komunikatën e OEK-ut.



## Filluan punimet për zgjerimin e hyrjes së Veternikut

PRISHTINË, 10 KORRIK (ER) - Ministri i Infrastrukturës dhe Transportit, Pal Lekaj, të mërkurën mori pjesë në fillimin e punimeve për zgjerimin e rrugës nacionale N2, segmenti hyrja në qytetin e Prishtinës nga ana e Veternikut, bashkë me urën që i lidhë rrugët nacionale N2 dhe N25.2, me kycjen e autostradës R7 "Ibrahim Rugova".

Ministri Lekaj ka theksuar se ky projekt, i cili është dashur të fillojë shumë më herët, është i domosdoshëm për ta përballuar fluksin e veturave

që ia mësyjnë Prishtinës. Me qëllim të evitimit sa më të shpejtë të kolonave në këtë zonë, ministri kërkoi nga kompania e kontraktuar që punët të përfundojnë sipas planit dinamik dhe në harmoni me standardet më të larta infrastrukturore.

Projekti për zgjerimin e rrugës nacionale N2 dhe N 25.2, bashkë me urën që i lidhë këto rrugë nacionale me kycjen e autostradës R7 "Ibrahim Rugova", ka kosto rreth 2.5 milionë euro. Ajo pritet të përfundojë për 155 ditë pune.



## Arrestohen tetë persona në Gjakovë të dyshuar për 'bixhoz të paligjshëm' dhe 'shmangie nga tatimi'



GJAKOVË, 10 KORRIK (ER) - Policia e Kosovës, konkretisht Drejtoria për Hetimin e Krimin të Organizuar - Sektori i Hetimeve, pas disa informatave të pranuar nga burime të sigurta, angazhimit të zhvilluar në terren për verifikim të informacionit si dhe veprimeve të tjera hetimore, është konfirmuar se në disa lokacione në Gjakovë është duke u zhvilluar veprimtari e kundërligjshme e lojërave të fatit, të cilat kohë më parë janë ndaluar me ligj.

Policia e Kosovës ka siguruar urdhër-kontroll nga Gjykata Themelore në Gjakovë, ku më

09. 07. 2019 janë kontrolluar nëntë lokale të ndryshme, në të cilat është vërtetuar se ishin duke u zhvilluar lojëra të fatit. Operacioni policor është mbështetur nga Njësia Speciale Operative, Krim Teknika Gjakovë, njësi të tjera relevante dhe inspektorë komunalë të KK Gjakovë. "Si prova materiale përkohësisht janë sekuestruar dëshmi relevante që do të përdoren në procedura të mëvonshme gjyqësore. Të dyshuarit, pas intervistës, me vendim të prokurorit të PTH Gjakovë janë dërguar në mbajtje deri në 48 orë", ka njoftuar Policia e Kosovës.

## UShAF-i hap konkurs për pranimin e studentëve të rinj

FERIZAJ, 10 KORRIK (ER) - Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF) ka hapur sot konkursin për pranimin e studentëve të rinj për vitin akademik 2019/20, sipas të cilit, do të pranohen 410 studentë. Në këtë vit akademik do të pranohen 340 studentë të rregullt, ndërsa 49 vende janë rezervuar për komunitetet joshumicë, pesë vende për kandidatët nga Mali i Zi, tetë nga Presheva, Bujanovci dhe Medvegja dhe tetë nga Shqipëria dhe Maqedonia e

Veriut. Këtë vit kandidatët për studentë të UShAF-it do të kenë mundësi të aplikojnë në programet: 1. Menaxhment i Turizmit dhe Hotelierisë, 2. Arkitekturë e Interierit dhe Dizajn i Mobileve, 3. Dizajn dhe Konstruksionet e Produkteve të Drurit, dhe 4. Inxhinieri Industriale me Informatikë. Konkursi do të jetë i hapur deri më 17 korrik 2019, në orën 16:00, ndërsa aplikimet dhe pranimi i dokumentacionit mund të bëhen çdo ditë (përfshirë edhe ditën e shtunë).



## Latifi zgjat orarin e punës dhe liron parkingun e komunës për bashkatdhetarët

RAHOVEC, 10 KORRIK (ER) - Kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka bërë me dije se me qëllim që bashkatdhetarët tanë të priten sa më mirë gjatë pushimeve të tyre, ka marrë dy vendime të cilat kanë për qëllim lehtësimin e qëndrimit të tyre në Kosovë. "Vendimi

i parë ka të bëjë me zgjatjen e orarit të punës për zyrtarët e gjendjes civile, zyrës së pranimi dhe zyrës së tatimit në pronë, të cilët nga 15 korriku do të punojnë deri në orën 18:00 gjatë ditëve të javës dhe nga ora 09:00 deri në orën 12:00 të shtunën, kurse me vendimin e dytë punëtorët e


komunës obligohen që t'i lirojnë hapësirat për parking në oborrin e komunës për mërgimtarët", ka shkruar Latifi në llogarinë e vet në "Facebook". Ai ka falënderuar mërgimtarët për kontributin e tyre për atdheun dhe ka siguruar se si komunë do të jenë në dispozicionin e tyre.





# Diplomatët që e shkëlqejnë epokën e bacë Adem Demës, ose për një vepër që është më shumë se diplomaci e më pak se politikë

(Sabri Kiçmari, "Fitorja diplomatike: kujtime nga përfaqësuesi diplomatik i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës", "Epoka e re", Prishtinë, 2017)



Prof. dr. Hakif BAJRAMI

Sabri Kiçmari si diplomat është pjekur me dituri dhe edukuar në një guximtar, ndër më të çmuarit nga shkolla emblematike e bacë Adem Demës, që mendon, flet dhe vepron drejt, për krijimin e neodiplomacisë dhe neoluftës, krejt me qëllim që me fuqinë e armës (UÇK-së) dhe me argumentin filozofik të drejtësisë ta çlirojnë Kosovën. Kjo shkollë emblematike ka emërues të për-bashkët Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Kjo ushtri në fjalorin filozofik-diplomatik i ka tre rektorë shkollorë për luftën e drejtë: Adem Jasharin - legjendarin, Zahir Pajazitin dhe Adrian Krasniqin, të ideuar gjithnjë nga kryerektori Adem Dema.

Është kënaqësi duke lexuar librin e prof. dr. Sabri Kiçmarit, "Fitorja diplomatike", kur e fillon tregimin e tij politiko-diplomatik dhe filozofik-shtetformues nga një pikë strategjike e Kosovës siç është Divjaka e Malishevës.

Edhe më ngrohtë, fillimin epokal e sublimon kur tërë epopeja fillon nga shtëpia e Nezir Zogajt, gjithnjë duke i pleqëruar çështjet e Lëvizjes Çlirimtare me korifentjtë e saj si janë Afrim Zhitia dhe Fadil Vata. Dhe, prapë pash-mangshëm duhet thënë se veprimtarinë e begaton duke bashkëvepruar me nxënësit ma të devotshëm të shkollës së sakrificës dhe vetëflijimit, të shkollës së Lëvizjes Revolucionare për bashkimin e shqiptarëve.

Po, kjo shkollë do të ngritët në erupcion revolucionar në Besi më 2 prill 1981, aktorët e së cilës dihen historikisht e që provuan t'ia kallin luftën Jugosllavisë, por që nuk patën popull për mejdan atëbotë. Aty forcave të okupatorit iu dëmtuan tërësisht tre kamionë me armë, kur u themelua Çeta e parë e rinisë patriotike të Kosovës, realitet ky që u avancua vite më vonë me "Çetën e Llapit", Çeta e heroit Ali Ajeti, pjesëtar i së cilës ishte edhe Sabri Kiçmari i njomë në moshë por i paepur me shokë për kauzën e lirisë. Kjo shkollë revolucionare kombëtare për një dekadë, po e shënonte hapin his-

torik, për ta shpalosur forcën shkollore intelektuale dhe punë-tore-qytetare pasuese, plotë të papritura dhe kthesa, por kurrë duke mos shënuar asnjë hap prapa. Këtë rrugëtim revolucionar Sabri Kiçmari, nuk mund ta bënte pa kaluar në ilegalitet, nga shtatori i vitit kuq e zi më 1988. Ky hap i ilegales nuk ishte vetëm koncept, por shtruarje e kërkesës: Kosova Republikë, plus kërkesa "Evropë help", për ta kuptuar delegacioni i Parlamentit Evropian, se demonstratat e majit 1989, janë njëherësh shpalosje e kërkesës që të njihet Evropa dhe ShBA me kursin civilizues shqiptar si rreshtim Properëndimor. Po, ky hap do të vulozet me gjakun e Ali Ajetit, për t'u forcuar edhe më 2 nëntor 1989 me gjakun e dy heronjve: Afrim Zhitisë dhe Fahri Fazliut. Edhe një herë, Sabri Kiçmari e mbaron maturimin e pjekurimit politik me kujtime, për Fadil Vatën i cili u nda nga jeta më 25 prill 1990 në Bazel të Zvicrës.

Me sistem shkollor, me kalimin e Sabri Kiçmarit në Gjermani, njëherësh fillon për te epoka e gjurmimit të heronjve të popujt tjerë, për të përfutur nga vepra e tyre shembuj pavdekësie. Kam përgatitur shumë doktorantë shqiptarë, dhe të tjerë joslavë për filozofin e historisë shqiptare dhe ballkanike. Por, kur e analizojmë hapërimin shkollor të Sabri Kiçmarit, më del përpara një personalitet, që është pjekë e stërpjekë para kohe, duke mësuar gjuhën e Hegellit, Getes, Shilerit, Hajnes, Shopenhauerit, duke grimcuar studime në filozofi politike në Bohum, në Bon, duke mos u kënaqur së studiuar herë si kureshtar e herë si subjekt ku jepen provimet, duke u ngjizur me shkencën, deri në përkushtim doktrinar, gjithnjë për t'i dalë krah atdheut dhe kombit dliresishtë.

Duke lexuar me një akribi studimin gnosologjik të Sabri Kiçmarit, sepse është aktual edhe sot (2019), pra syve të del personazhi që "zhvillon në të njëjtën kohë dy ofensiva për njohje të një lufte të drejtë, që njëherësh ishte korrigjim i gabimeve mizore që kishte bërë Diplomacia evropiane ndaj Çështjes shqiptare 1878-1989: zhvillon debate programore në interes të Lëvizjes Kombëtare (deri në gusht 1993), për ta konceptuar bazën ideore dhe teorike, filozofiko-politike dhe


diplomatike të institucionit, që kombit shqiptar do t'i ngritë famë dhe lavdi, kudo në glob me emrin e UÇK-së. Kështu me diturinë e fituar me djersë, në universitetet gjermane Sabri Kiçmari, do të mësojë se UÇK-ja është lehtë të shpikët, por është përgjegjësi megametrike për ta lindur dhe për ta ndërgjegjësuar e rritur përmes alternimit Republikë e Kosovës, nga një politikë poltrone e deklaratave në politikë të rreshtimit perëndimor, politikë aktive dhe e sakrificave deri me jetë e gjak, së cilës vet me shokë shumë i bëhen dokument inductiv dhe ngadalë deduktiv identifikimi, nga detyrat e shkrepjes së plumbave të parë deri te ofensiva e dytë fitimtare për ta vulosur të parën, atë narrativen, por jo për interes të ngushtë, por nga imponimi dhe obligimi kombëtar patriotik, për një kauzë që quhet pavarësi e sovranizuar legale dhe legjitime. Dhe kur UÇK-ja lëshoi shtat, gati pa dijen e opinionit kombëtar, kjo djalëri shqiptare në shumë qendra të fuqisë, do ta shtrojë kërkesën e radhës, që ta konceptojë deri në doktrinë shkollore luftën e armatosur dhe të komanduar nga një qendër, sepse kishte grumbulluar mjaftë dituri profesionale me që kishte mjaftueshëm edhe energji patriotike, prandaj do ta merr mbi supe përfaqësimin e UÇK-së (jo vetëm ky - H. B.), jo si propagandë por si realitet duke e përhap lajmin e gëzueshëm andej ku flitet gjuha anglishte, gjermane, frëngjishte, hungarishte, norvegjishte, kroatishite, mjaftueshëm për t'u bërë faktor që fletë seriozisht dhe nuk hamendet në qëllime që shfaqen si kauzë, që lufta e armatosur të zhvillohet vetëm për liri dhe bashkim kombëtar. Në këtë drejtim, duke lexuar studimin shumë të homerizuar shkencër-

ishtë të Sabri Kiçmarit, disi nuk del në shesh pyetja hamletiane, a më vështirë ka qenë luftimi i saboterëve të luftës brenda kombit, e që në shkallë megametrike ende quhet "institucionalistë", edhe pse e dinin se oportunistizmi brenda kombit po i sjellë popullit viktima. Këtu shtrohet një pyetje që nuk është apokaliptike dhe hezitive, për kastën elite të saboterëve obaskurantistë, a kanë mundur dhe pse nuk i janë bashkuar kultivimit dhe avancimit të Ushtrisë Çlirimtare, së cilës si faktor do t'ia kanë frikën të gjithë ata që frenojnë dhe robërojnë energjinë çlirimtare të popujve të robëruar. Të përgjigjesh në këtë pyetje, pa u botuar dokumentet e njëres dhe palës tjetër, disi më duket se vetëm do të kalonim në një debat fluid dhe atrifik, madje edhe insufinet, me plotë fabula ku kombin e vjen para detyrave që nuk duhet varur në qafë askujt, sepse kombi nuk i meriton sigabime të një klase apo kaste, e cila vetëm merr dhe nuk jep asgjë, që ma në fund provoi të injektohet në shkallë dinake edhe në UÇK si "FARK", pa emblemë të saj me "kunar", e që sabotoi hapur dhe iku si qyqet, për të mbetur turpi i kombit. E ky fakt duhet thënë herë dokurdo, sepse pala refuzuese e luftës së drejtë ende është e freskët në kujtime, e çka do të bëhet kur të botohen dokumentet bile edhe të armikut; çka do të ndodhë kur të botohen faktet e qeverisë mercenare të prill-majit 1999, çka do të "ndodhë" kur të botohen dokumentet e misionarëve të shumtë që kalëronin nëpër Kosovë, çka dhe kush do të turpërohet kur të botohen dokumentet e vizionarëve dhe luftëtarëve të vija të para të luftës, sepse për çdo vit, sapo kalojnë vitet kësaj shtrese po i jepet infuzion partioid, se edhe ata

paskan participuar në UÇK, bile në disa raste ua paskan kaluar emblemistëve që e skuqen tokën e Kosovës me vagoj gjaku. Lufta e UÇK-së më realitet nuk ishte luftë partie e dikush donte ushtri partiake të kobshme, do të njihet në popull vetëm atëherë kur do t'i kemi botuar dokumentet autentike, dhe nuk paragjykojë se atëherë fytyrat e turpshme do të mbesin vetëm statua dhe fotose të tradhtisë, kudo dhe kahdo që po vendos.

Pse po e them këtë?

Derisa në Koshare luftohej për jetë a vdekje, dikush shëtitej herë në Shkup e herë në Prishtinë e kur mbaroi kjo tragjikomedi shëtitja vazhdoi herë në Romë e herë në Gjermani dhe anasjelltas, duke krijuar teatër me një pjesë të mafisë së "Shën Exiudios". Po, kur e kuptuan disa çarqe se Ushtria e Adem Demaçit me sulmin e rufeshëm në Koshare dhe Pashtrik, dhe kudo nëpër Kosovë, duke u frikësuar se lufta e UÇK-së po avancohet në neoluftë dhe do ta çlirojnë Kosovën me arme, adete dhe zakone të veta, dikush furishëm nxitoi të nxirrte Rezolutën në KS OKB nr. 1244, për t'ia hapur mundësinë që në Kumanovë të nënshkruhet kapitullimi i okupatorit pakusht. (Lexoni dok. në original - anglisht, H. B.). E vërteta, akuza ndaj luftës së UÇK-së si "terroriste" edhe në Perëndim edhe në Lindje dihet, e kur t'i shtohet këtij qëndrimi edhe kualifikimi që i bëhej luftës së drejtë nga ata që SABOTONIN, madje edhe fyenin, në esencë, i tërë ai rreshtim si në kor kundër luftës disi nuk e dinin se i diskualifikonte të gjitha krimet e okupatorit. Mu për këtë, lufta diplomatike e përfaqësueseve të UÇK-së, bëhet të kualifikohet se ishte madhështore. (Vijon)





**E rrallë**

# Kalaveshi i rrushit shitet për 11 000 dollarë në Japoni

Menaxheri i një zinxhiri të hoteleve është shpallur fitues i një ankandi për shitjen e një kalaveshi të rrushit. Kalaveshi i quajtur "Ruby Roman" është shitur të martën në Kanazaua të Japonisë. Takashi Hosokaua



do të paguajë 1.2 milion jen, apo 11 000 dollarë për kalaveshin me 24 kokrra të rrushit. Ky rrush i kuq është i veçantë për shkak se është shumë i lëngshëm, ka shumë sheqer dhe aciditet të ulët.

## BARSOLETA E DITËS




**Mësuesi e pyet Benin:**  
 - Beni, çfarë të ndodhë nëse ta shkul njërin vesh?  
 - Do të bëhem gjysmë i shurdhër, profesor.  
 - Po nëse ta shkul edhe tjetrin?  
 - Do të ngelem qorr, profesor.  
 - E si ka mundësi të ngelesh qorr?  
 - Po s'kam ku t'i var syzet.



### Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

**Ne ora 16:00 (vikendit ne ora 14:00 dhe 16:00)**  
**"THE SECRET LIFE OF PETS 2" 3D**

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 ore 26 min  
**Rolet:** Kevin Hart, Tiffany Haddish, Harrison Ford, Patton Oswalt, Eric Stonestreet, Jenny Slate, Lake Bell, Hannibal Buress, Nick Kroll, Dana Carvey, Ellie Kemper, Pete Holmes, Garth Jennings, Bobby Moynihan  
**Regjia:** Chris Renaud and Jonathan Del Val



**Ne ora 18:00**  
**"X-Men; Dark Phoenix"**

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 1 orë 53 min

**Rolet:** James McAvoy, Michael Fassbender, Jennifer Lawrence, Nicholas Hoult, Sophie Turner, Tye Sheridan, Alexandra Shipp, Kodi Smit-McPhee, Evan Peters, and Jessica Chastain  
**Regjia:** Simon Kinberg



**Në ora 20:00**

**"MEN IN BLACK; INTERNATIONAL" 3D,**  
 Aksion/Komedi/Sci-Fi; 1 orë 55 min

**Rolet:** Chris Hemsworth, Tessa Thompson, Kumail Nanjiani, Rebecca Ferguson, Rafe Spall, Laurent Bourgeois, Larry Bourgeois, Emma Thompson, Liam Neeson  
**Regjia:** F. Gary Gray



**Ne ora 22:00**

**"M A"**

Horror/Triller; 1 ore 39 min

**Rolet:** Octavia Spencer, Juliette Lewis, Diana Silvers, Luke Evans, McKaley Miller, Missi Pyle, Corey Fogelmanis, Gianni Paolo, Dante Brown  
**Regjia:** Tate Taylor



**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**

**FOTO E DITES**



Ujqini të martën është goditur nga një stuhi e fuqishme. Janë dëmtuar makina, rrëzuar drunjtë, pushimore. Dëme të mëdha ka pasur edhe në shëtitoren e plazhit.

**E jashtëzakonshme**

## Hot dogu 30 kilogramësh mbi një metër i gjatë

Një hot dog gjigant që peshon 30 kilogramë është munduar të "vë rekord të ri" në librin "Guinness", duke u bërë kështu hot dogu më i gjatë në botë. Për ta transportuar janë dashur tre burra pasi ishte 1.5 metra i gjatë dhe mishi i tij ishte 100 për qind prej lopës, ku për dy orë është pjekur dhe më pas është vendosur në bukë.



Rekordin për hot dogun më të gjatë në botë e mban ai i Paraguit, ku në vitin 2011 u përgatit dhe ishte 203.8 metra i gjatë.

 <p><b>DASHI</b> Shumë shpesh humbni në botën e ndjenjave, por kjo gjë ju bën shumë të ndikueshëm dhe mjaft të paqëndrueshëm.</p>	 <p><b>DEMI</b> Si fillim duhet ta krijoni terrenin e përshtatshëm, pastaj të procedoni për t'i realizuar projektet tuaja ambicioze.</p>	 <p><b>BINJAKËT</b> Kurioziteti është arma juaj kryesore sot dhe është një nga virtytet tuaja më të mira. Gjithmonë kërkoni informacion përpara se të veproni.</p>	 <p><b>GAFORRJA</b> Miqte mund të kenë gjithmonë besim te ju se dini t'i ruani sekretet dhe jeni mjaft të rezervuar për t'i shprehur ndjenjat tuaja.</p>	 <p><b>LUANI</b> Edhe pse dëshironi të dominoni dhe të jeni gjithmonë në rolin e liderit, sot do të dini të ofroheni me shumë qetësi për një mbështetje morale.</p>	 <p><b>VIRGJËRESHA</b> Edhe pse në ditët që do të vijjnë do të keni shumë ngarkesë në punë, do të dini se si ta përballoni më së miri.</p>
 <p><b>PESHORJA</b> Përpikuni të jeni të kuptueshëm sot dhe matni fjalët që thoni. Mund të lëndoni pa dashje dikë për të cilin keni shumë respekt.</p>	 <p><b>AKREPI</b> Gjithmonë arrini t'i gjeni zgjidhjet shumë më përpara të tjerëve falë intuitës suaj të pagabueshme që ju ndihmon gjithmonë.</p>	 <p><b>SHIGJETARI</b> Optimist dhe pozitiv, gjithmonë e shikoni gotën gjysmëplot. Por edhe te njerëzit përçoni të njëjtën ndjesi.</p>	 <p><b>BRICJAPI</b> Nuk ju tremb aspak koha që duhet të impenjoheni për të zgjidhur një çështje të caktuar. Jeni mjaft i përqendruar në detaje.</p>	 <p><b>UJORI</b> Mendoni se të tjerët përkushtohen ndaj jush në të njëjtën mënyrë si ju ndaj tyre. Sot do të pësoni një zhgënjim lidhur me një person.</p>	 <p><b>PESHQIT</b> Keni shumë gjëra pozitive si tip, jeni të ndershëm dhe mjaft korrekt me ata që ju rrethojnë. Sot kjo gjë do të vlerësohet.</p>





**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN  
SEKURIT  
PILKINGTON  
Enveri

Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
"BUJQËSIA"  
TEL: 045/82 82 82

## Feronikeli t'i hapë dyert e 'Fadil Vokrrit'



Sadik ZEQRIRI

Klubi i Kosovës, Feronikeli, që ende është pjesë e garave evropiane, pra Ligës së Kampionëve, është para një suksesi të madh. Klubi i "Nikli"-t është në prag të kualifikimit në rrethin e dytë, pasi arriti një barazim në katër minutat e fun-

dit të ndeshjes ndaj TNS-së në Uells (2-2) andaj, tash, përveç fitores për kualifikim, i mjafton edhe një barazim pa gola (0-0), ose një barazim me rezultat 1-1. Siç dihet, pas një loje dhe paraqitje shumë të mirë të ekipit nga Drenasi kundër kampionit të ligës së parë të Uellsit, mundësitë për t'u kualifikuar më tutje janë rritur dukshëm dhe të martën e ardhshme, më 16 korrik, në stadiumin "Fadil Vokri", nga ora 20:45, do të luhet ndeshja e kthimit. Me këtë datë dhe në këtë kohë duhet që të gjithë dashamirët e sportit në

përgjithësi dhe të futbollit në veçanti të vijnë dhe t'i mbushin tribunat e "Fadil Vokrrit". Asnjë ulëse në stadiumin që e mban emrin e Vokrrit nuk bën të mbetet e zbrazët, pasi këtu nuk luhet vetëm për suksesin e klubit të Feronikelit, por për sukseset e futbollit dhe të shtetit të Kosovës në përgjithësi. Po ashtu, duhet t'ia bëjmë me dije TNS-së, në shkuarje dhe FC Kobenhavn në ardhje, se Kosova, edhe pse është pranuar pak vite më parë në FIFA dhe UEFA, përpos futbollistëve fantastikë, ka edhe shikues dhe dashamirë të flaktë

të cilët mbushin stadiumet edhe kur klubet tona nuk arrijnë rezultate pozitive.

Kryetari i Klubit të Feronikelit, biznesmeni i suksesshëm Naser Ramaj, i cili është më meritori për sukseset e këtij klubi, pasi është duke investuar miliona në të, këtë herë nuk do të duhej të kërkonte fitime nga biletat e shitura për këtë ndeshje, e që mund t'i fitojë rreth ose mbi 20 mijë euro, por t'i hapë dyert e stadiumit për dashamirët e futbollit, që të kenë mundësi ta shikojnë ndeshjen falas. Të paktën, të mundësojë që tribunat në

pjesën veri-jug t'i lë pa pagesë. Skuadra e Feronikelit momentalisht është më e mira në vend dhe pjesë e saj janë futbollistët më të mirë që i ka Kosova dhe me plot meritë është fituese e titullit dhe Kupës në edicionin e fundit. Besoj shumë në suksesin historik të saj në Ligën e Kampionëve. Besoj shumë në përkrahjen e dashamirëve të futbollit për këtë ekip tonin historik.

Ejani, më 16 korrik, në stadiumin "Fadil Vokri", me fillim nga ora 20:45.

Ta gëzojmë fitoren bashkërisht!

## Polica e Kosovës bëhet me federatë dhe klube sportive

Drejtnesit e KOK-ut kanë kërkuar nga ministri i Punëve të Brendshme (MPB), Ekrem Mustafa, që të formohen klubet sportive brenda Policisë së Kosovës, në të gjitha komunat dhe njësitet e policisë, si dhe të formohet Federata Sportive e Policisë së Kosovës

PRISHTINË, 10 KORRIK - Në vazhdim të takimeve me ministrat e Qeverisë së Republikës së Kosovës, drejtnesit e Komitetit Olimpik të Kosovës, kryetari Besim Hasani dhe sekretari i përgjithshëm, Shasivar Haxhijaj, janë takuar të mërkurën me ministrin e Punëve të Brendshme (MPB), Ekrem Mustafa.

Presidenti Hasani, duke falënderuar ministrin Mustafa për takimin, e përgëzoi për punën e Policisë së Kosovës. Edhe ministri Mustafa e përgëzoi presidentin Hasani për të arriturat në fushën e sportit, me theks të veçantë për suksesin e fundit në Lojërat Evropiane "Minsk 2019", ku u fituan tri medalje. "Drejtnesit e KOK-ut kërkuar që të formohen klubet sportive brenda Policisë së Kosovës, në të gjitha komunat dhe njësitet e policisë, po ashtu të formohet edhe Federata Sportive e Policisë së Kosovës, e cila do t'i hapte rrugë aplikimit për anëtarësim në Federatën Evropiane dhe Ndërkombëtare të Sporteve të Policisë. Ashtu si me ministrat e tjerë, u kërkuar edhe nga ministri Mustafa punësimi i



sportistëve elitare dhe trajnerëve në Policinë e Kosovës", thuhet në njoftimin e KOK-ut. Bashkëpunimi intensiv dhe i planifikuar për aktivitete të përbashkëta mes KOK-ut-MPB-së dhe Policisë së Kosovës, siç janë Dita Olimpikë, Festivali Sportiv për Parashkollorët, Dita Ndërkombëtare e Sportit dhe Ambientit, Dita Botërore e Ecjes etj., ishte një tjetër temë diskutimi.

Ministri Mustafa dhe ekipi i tij

shprehën falënderimin për idetë e propozuara, njëherësh konfirmuan gatishmërinë për t'i gjetur modalitetet më të përshtatshme në përputhje me legjislacionin dhe procedurat në fuqi. Të dyja palët u pajtuan që të themelohen grupet punuese nga të dyja palët për ta hartuar një memorandum bashkëpunimi me qëllim të thellimit të bashkëpunimit institucional midis Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Komitetit Olimpik të Kosovës.



## Ramadani: Na duhet më shumë guxim për kualifikim

DRENAS, 10 KORRIK - Trajneri i Feronikelit, Zekirija Ramadani, ka folur pas barazimit ndaj TNS-s, me rezultat 2-2. Feronikeli ishte në disavantazh prej dy golave, por arriti të nxjerrë një barazim tejet të rëndësishëm në minutat e fundit të takimit. Ramadani thotë të jetë tejet i kënaqur me rezultatin, por kërkon lojë më të guximshme nga minuta e parë. "Ishte ndeshje e jashtëzakonshme, patjetër që jam i kënaqur me rezultatin, por dua të luajmë më guximshëm që nga minuta e parë e ndeshjes. Treguam se ekipi e di se çka dëshiron. Edhe para ndeshjes isha i kënaqur me një barazim me gola, por mënyra se si erdhi

barazimi e bëri më të veçantë. Secilën ndeshje po tentojmë çdoherë e më shumë ta jetësojmë filozofinë e lojës sonë. Është normale që na mungon përvoja, por ajo fitohet në duele të tilla. Nga pikat e mira të ndeshjes dua ta veçoj lojën në ajër, ku fituam shumicën prej dueleve, sidomos gjatë fundit të takimit", ka thënë Ramadani. "Tani ky rezultat është më i favorshëm për ne, por duhet të jemi tejet të kujdesshëm, pasi luajmë ndaj një skuadre që ndëshkon çdo gabim. Në ndeshjen e dytë do të doja të shënojmë në fillim, e pastaj të luajmë një lojë të kujdesshme", ka deklaruar Ramadani.

## Gilberto Fortunato: U riktheva për titullin kampion

Gjilan, 10 korrik - Ish-kampionia e Kosovës në futboll, Drita, e ka rikthyer në Gjilan ish-sulmuesin e Tiranës dhe Flamurtarit, Gilberto Fortunato. Sulmuesi

braziliani ka qenë pjesë e Dritës edhe në vitin 2016, ku u aktivizua 9 ndeshje, duke realizuar 2 gola. Gilberto më pas u largua pasi kishte një ofertë të majme nga

Malajzia. Së fundmi Fortunato ishte pjesë e ekipit Sport Boys në Bolivi, teksa karriera ka qenë e larmishme. 31-vjeçari ka zbuluar se është rikthyer për ta fituar titullin e kampionit në elitën e futbollit të Kosovës. "FC Drita u riktheva, por kësaj herë për t'u bërë kampion", ka thënë Gilberto Fortunato.

ullin e kampionit në elitën e futbollit të Kosovës. "FC Drita u riktheva, por kësaj herë për t'u bërë kampion", ka thënë Gilberto Fortunato.





## Lushtaku sqaron pse Dervishaj u prezantua te Drenica dhe Vushtrria

SKENDERAJ, 10 KORRIK - Në futbollin kosovar shpeshherë ndodhin gjëra të pazakonta. Një ndër to është edhe rasti me lojtarin Besfort Dervishaj. Më 8 qershor skuadra e Drenicës kishte njoftuar se kishte nënshkruar me talentin Dervishaj. Sipas faqes zyrtare të kuqez-

injve, ai kishte nënshkruar kontratë për dy vjetet e ardhshëm. Por disa ditë më pas skuadra e Vushtrrisë kishte prezantuar të njëjtin lojtar si përforsim. Trajneri i Drenicës, Tahir Lushtaku, sqaroi se pse ndodhi një gjë e tillë. "Besarti ka qenë futbollist i Drenicës, e

kemi vazhduar normalisht kontratën dhe me marrëveshje të dyanshme jemi pajtuar që të jetë pjesë e Vushtrrisë për një sezon dhe mbas një viti ai të kthehet sërish në Drenicë. Në njëfarë forme është si huazim e vërteta për Dervishin", ka thënë Lushtaku.



## Shabani: Kosova do të ketë paraqitje dinjitoze në Evropianin U19

PRISHTINË, 10 KORRIK - Përzgjedhësi i ekipeve përfaqësuese të Kosovës në hendboll (femrat), Agron Shabani, është i kënaqur me punën që është bërë nga hendbollistët në Raiffeisen Kampin e mbajtur në Gjakovë e, po ashtu, me përgatitjet që po bën Përfaqësuesja U19, e cila po përgatitet në Gjakovë për Kampionatin Evropian, Divizioni B, që mbahet në Lituani. Kosova U19 është në Grupin A, ndërsa ndeshjen e parë e luan më 15 korrik ndaj Turqisë. Më 16 korrik takohet me Çekinë, ndërsa tri ditë më vonë takohet me Ishujt Faroe. Më pas Kosova U19 ka edhe ndeshjet për plasman përfundimtar. Shabani është me hendbollistët prej fillimit të kampit, ndërsa tani së bashku me trajnerin e grupmohës U19, Faruk Shala dhe trajnerin e portiereve, Valbona Rudaku, po vazhdojnë punën me Përfaqësuesen e kësaj grupmoshe. Shabani do të jetë me ekipet U19 e U17 në evropianët e kësaj vere, i cili mbahet në Itali gjatë muajit gusht. "Me punën që kemi bërë së bashku me stafin jam shumë i kënaqur. Kemi punuar intensivisht me dy grupe, çdo ditë nga gjashtë orë. Edhe pse ishte vapë e madhe, nuk jemi kursyer duke punuar. Mendoj se shumë vajza të reja dhe me perspektivë kanë marrë me vete përvojë të madhe dhe shumë risi në zhvillimin e talentit që e kanë", ka thënë Shabani.



Puna me U19 ka filluar me të nisur kampi, ndërsa është vazhduar prej të dielës vetëm me këtë grupmohë. Pra, nuk është ndalur fare. Gjatë kampit është bërë seleksionimi i vajzave, ndërsa tani stafi i trajnerëve po punon për përgatitje të ekipit për kampionat evropian. "Mendoj se duke iu falënderuar vajzave të cilat vijnë nga diaspora, por edhe atyre që karrierën e zhvillojnë në Kosovë, kemi mundësi që së paku të prezantohemi me dinjitet në Evropian. Të gjitha vajzat e ftuara nga trajneri Faruk Shala janë paraqitur në fazën përgatitore, por disa, për fat të keq, është dashur të largohen në momentin e fundit për shkak të provimeve pranuese që i kanë në fakultet më

15 korrik. Bëhet fjalë për Blerta Ahmetxhekajn dhe Yllka Shatrin që nuk do të udhëtojnë në Evropianin që mbahet në Lituani", ka deklaruar Shabani. U19-shet të shtunën udhëtojnë për në Lituani, kurse U17-shet evropianin e kanë në Itali gjatë muajit gusht. "Për Përfaqësuesen U17 ishte grumbullimi i parë gjatë kampit. E kemi bërë seleksionimin dhe jemi në formim të ekipit. Vajzat prapë bashkohen në përgatitje para se të udhëtojmë në Itali. Janë disa vajza nga diaspora që kanë përvojë më të madhe dhe me ato bashkohen disa vajza të talentuara nga ekipet tona. Por do të përpiqemi maksimalisht për paraqitje të dinjitetshme", ka përfunduar Agron Shabani.

## McLaren ia mbylli derën rikthimit të Alonsos

MADRID, 10 KORRIK - Pas Ferrarit edhe makina McLaren i ka mbyllur derën një rikthimi të mundshëm të pilotit spanjoll Fernando Alonso vitin e ardhshëm në Formula 1. Makina britanike ka konfirmuar se britaniku Lando Norris (19 vjeç) dhe spanjollit Carlos Sainz (24 vjeç) do të jenë pilotët e McLarenit edhe në vitin 2020. "Duke parë rezultatet e mira që Lando dhe Carlos kanë arritur këtë sezon, ne u ulëm dhe biseduam me ta në lidhje me të ardhmen e McLarenit. Vendosëm që ky bashkëpunim mes McLarenit dhe dy pilotëve të vazhdojë edhe në sezonin tjetër", ka thënë Zak Brown, drejtori sportiv i makinës britanike. Skuadra shfrytëzoi një klauzolë në



kontratë për ta rinovuar edhe për një vit kontratën e pilotëve. Sainzi është një pilot me më shumë përvojë, por edhe Norrisi, që këtë vit debutoi në Formula 1, në 4 gara ka hyrë në zonën e pikëve. McLaren ndodhet në vendin e katërt të renditjes së makinave me

52 pikë. "Dua të mbyllim çdo spekulim në lidhje me të ardhmen e pilotëve tanë, ndaj vendosëm të zyrtarizojmë që tani pilotët e vitit 2020. Carlos dhe Lando janë të rëndësishëm në progresin e punës sonë", ka deklaruar Browni.

### SHKURT

#### Costa, afër rikthimit në Premierë Ligë

Diego Costa ka kontratë edhe për dy vjet të tjera me Atletico Madridin, por blerja e Alvaro Moratas mund të bëjë që sulmuesi Costa të largohet në këtë afat kalimtar. Mediet në Spanjë raportojnë se Costa do të rikthehet në Premierë Ligë, pasi skuadra e Wolverhampton Wanderersit është shumë e interesuar për transferimin e tij. Costa ka luajtur edhe për Penafiel, Bragan, Rayo Vallecano, Valladolid, Albacete dhe Celta Vigon.

#### Bayerni vihet pas Underit

Bayern Munchen është duke punuar intensivisht për t'u gjetur zëvendësuesit e Arjen Robbenit dhe Franck Riberys. "Kicker" raporton se klubi gjerman ka shfaqur interesim për yllin e Romës, Cengiz Under. Sulmuesi turk shihet si një lojtar me perspektivë të madhe dhe klubi gjerman nga "Alianz Arena" kërkon që transferimi i tij të realizohet sa më parë. Bayerni, gjithashtu, po i kërkon edhe Leroy Sane e Manchester Cityt dhe Ousmane Dembelen e Barcelonës.

#### Bale refuzon transferimin në Kinë

Gareth Bale vazhdon të jetë i vendosur që mos të largohet nga skuadra e Real Madridit, prandaj sulmuesi nga Uellsit e ka refuzuar mundësinë që të transferohen në Kinë. Oferta ka qenë mjaft e lartë, por Bale preferon të jetë pjesë e Realit, të paktën edhe për tri edicione të tjera. Më herët është folur se Bale mund të rikthehet në Premierë Ligë, por edhe ky opsion bie poshtë për faktin se ish-anëtarit i Tottenham Hotspurit po mendon vetëm për Realin.

#### Solskjaeri: Nuk kemi marrë oferta për Pogban dhe Lukakun

Trajneri i Manchester Unitedit, Ole Gunnar Solskjaer, ka zbuluar se ende nuk kanë marrë oferta për asnjë prej lojtarëve të tyre, përfshirë Paul Pogban dhe Romelu Lukakun. Pogba ka qenë i lidhur me një kalim në skuadrën e Real Madridit ose rikthimin në Juventus, ndërkohë për Lukakun është folur se mund të largohet nga Unitedi për t'iu bashkuar Interit. "Ka pasur shumë fjalë dhe spekulime për shumë nga lojtarët tanë. Për mua, është biznes si zakonisht. Kur jeni në United, ju presin që të gjitha këto gjëra gjatë verës dhe sigurisht, kam qenë në kontakt me Pogban, Lukakun, Rashfordin dhe Lingardin. Për aq sa jam i vetëdijshëm dhe deri më tani, nuk kemi marrë asnjë ofertë për asnjë prej lojtarëve tanë... Paul, ose shumica e lojtarëve tanë, kanë kontrata të gjata", ka thënë Solskjaer.

#### Formacioni i Kupës së Amerikës, mungon Messi

Është publikuar nga "CONMEBOL" formacioni me lojtarët që kanë pasur paraqitjet më të mira gjatë garës në Kupën e Amerikës. Kombëtarja e Brazilit e fitoi trofeun, pasi e mposhti Perunë në finalen që u zhvillua në stadiumin "Maracana", me rezultat 3-1. Brazili në këtë formacion prinë me pesë lojtarë, i ndjekur prej dy lojtarëve të Perusë. Kili, Argjentina, Uruguai dhe Kolumbia kanë nga një lojtar. Në këtë formacion mungon ylli i Argjentinës, Lionel Messi. Formacioni i Kupës së Amerikës: Alisson, Alves, Gimenez, Silva, Trauco, Arthur, Paredes, Vidal, James Rodriguez, Everton, Guerrero.



Opština Gjakovë / Gjakovë Municipality  
N.P.L. "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A. GJAKOVË

Nr. 323  
Data: 10.07.2019

N.P.L. "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A. GJAKOVË

KE: 0390/320 010  
E-mail: nplsagj@gmail.com  
Info: 0390/324 268  
Web:

Nr. Biznesit: 71228673  
Nr. Fiskal: 601568233  
Nr. TVSH: 330311853  
BEK: 140200001784638

Në mbështetje të nenit 8 të Ligjit të punës nr.03/L-212, të Republikës së Kosovës, nenit 4 pika 1,2,3,4,5 dhe nenit 5 të Udhëzimit Administrativ nr.07/2017 për Regullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, nenit 3 të Regullores nr.167 të datës 06.05.2016 mbi Mardhënie në Punë të Punëtorëve dhe neni 15 pika 19 të Regullores nr.121 të dt. 04.04.2016 për Organizimin e Mbrendshëm, Caktimin e Pozitave, Detyrave dhe Përgjegjësi të Stafit Punues, dhe vendimit nr. 327 të datës 10.07.2019 të Kryeshefit Ekzekutiv, N.P.L."Stacioni i Autobusëve"SH.A.,Gjakovë, shpallë këtë:

**KONKURS**

- Pozita: Rojtar**
- Numri i pozitave: 1 (një)**
- Kohëzgjatja e punës: 1 (një) vit me mundësi vazhdimi**
- Detyrat dhe përgjegjësit:**
- Bën sigurimin e objektit të kompanisë dhe hapsirave përreth;
  - Në rast të vërejtjes së rrezikut nga zjarri apo rreziqeve tjera ndërmer masat më efektive dhe menjëherë kërkon ndihmë për evitimin e të metave;
  - Në rast sulmi ndërmerr masa të caktuara konform rregullores mbi punën e shërbimit në sigurimin fiziko – teknik të objekteve;
  - Të gjitha të metat e vërejtura i shënon në libër të vërejtjeve dhe mbi të njejtat e informon personin përgjegjës të tij;
  - Bën kontrollimin e materialeve, objektit ,automjeteve dhe personave të cilët hyjnë dhe dalin në ndërtesë,njëherit në libër i shënon hyrjet dhe daljet e tjera në kohën kur nuk punohet ose jashtë orarit;
  - Nuk lejon daljen e mjeteve në tërësi nga objekti , nëse për këtë nuk posedon një urdhër me shkrim ;
